



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.76 dt.05.06.1998

**“MBI
KALIMIN NE FOND BANESE ISH TRUP ROJEN
E KLUBIT SPORTIV PARTIZANI”**

Këshilli Bashkiak i qytetit të Tiranës, i mbledhur sot me dt.05.06.1998, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Ndërtim Strehimit “Për kalim në fond banese”, ish trup-rojën në hyrje të Klubit Sportiv Partizani, bazuar në Ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal” si dhe në zbatim të V.K.M. Nr.379, dt.26.06.1995 për disa shtesa e ndryshime në V.K.M. Nr.81, dt.28.02.1994 “Për kthim në banesa të objekteve që mbeten të lira nga ristrukturimi i Ushtrisë dhe Ministrisë së Rendit Publik”, pika.2,

VENDOSI

1. Objekti “ish – trup roja” në hyrje të Klubit Sportiv Partizani në Rr.”F.Plaku” të kalojë në fond banese.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Shërbimeve(Drejtoria e Ndërtim Strehimit) për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI